

B A N K A E S H Q I P Ë R I S Ë

B U L E T I N I Z Y R T A R

V Ë L L I M I 7, N U M R I 15, N Ë N T O R 2005

Data e botimit 23.11.2005

P Ë R M B A J T J A

1.	Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 84, datë 16.11.2005 "Për miratimin e rregullores "Mbi tregun sekondar ndërbankar të letrave me vlerë të Qeverisë të Republikës së Shqipërisë"	4
2.	Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 87, datë 16.11.2005 "Për shfuqizimin e vendimit nr. 26, datë 29.03.2000 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë"	10
3.	Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 88, datë 16.11.2005 "Për një ndryshim në rregulloren "Për licencimin e subjekteve jobanka"	12
4.	Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 89, datë 16.11.2005 "Për disa ndryshime në udhëzimin "Për blerjet dhe shërbimet në vlerë të vogël në Bankën e Shqipërisë"	13
5.	Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 90, datë 16.11.2005 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë"	14
6.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 1, Shkurt 2005	16
7.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 2, Shkurt 2005	16
8.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 3, Shkurt 2005	16
9.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 4, Prill 2005	16
10.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 5, Prill 2005	16
11.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 6, Maj 2005	17
12.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 7, Maj 2005	17
13.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 8, Qershor 2005	17
14.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 9, Qershor 2005	17
15.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 10, Korrik 2005	18
16.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 11, Gusht 2005	18
17.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 12, Shtator 2005	18
18.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 13, Tetor 2005	18
19.	Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 14, Nëntor 2005	18



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

NR.84, DATË 16.11.2005

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI TREGUN SEKONDAR NDËRBANKAR TË LETRAVE ME VLERË TË QEVERISË TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, neni 1, pika 4, shkronja “ç” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, neni 26, pika 3, shkronja “c”, paragrafi “ii”; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Të miratojë rregulloren **“Mbi tregun sekondar ndërbankar të letrave me vlerë të Qeverisë të Republikës së Shqipërisë”**, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe i Komunikimit me publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
i

SEKRETARI
YLLI MEMISHA

KRYETARI
ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

RREGULLORE
MBI TREGUN SEKONДАР NDËRBANKAR TË LETRAVE ME VLERË TË QEVERISË TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", neni 1, pika 4, shkronja "ç"; ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neni 26, pika 3, shkronja "c", paragrafi "ii"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 694, datë 11.12.1995; të marrëveshjes midis Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë "Mbi emetimin e bonove të thesarit në formë regjistrimi", datë 8 korrik 2002, me gjithë ndryshimet përkatëse; të marrëveshjes midis Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë "Mbi emetimin e obligacioneve në formë regjistrimi", datë 24.09.2002, Banka e Shqipërisë nxjerr rregulloren e mëposhtme:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

Banka e Shqipërisë organizon tregun sekondar të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Ky treg shërben për tregtimin e letrave me vlerë të emetuara nga Republika e Shqipërisë në ankandet e tregut primar si dhe përdorimin e letrave me vlerë si mjete për garantimin e kryerjes (ekzekutimit) së operacioneve të ndryshme në tregun ndërbankar.

NENI 2

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

Treg primar, është tregu në të cilin kryhet rregullisht blerja nga të gjitha subjektet përkatëse të letrave me vlerë të emetuara rishtazi nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Treg sekondar, është tregu në të cilin kryhet rregullisht blerja dhe shitja e letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ndërmjet bankave që i zotërojnë ato.

Letra me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, janë instrumentet që krijojnë apo konfirmojnë borxhin e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në formën e mëposhtme:

a. bono të thesarit;

b. obligacione me afat maturimi 2 (dy) dhe 3 (tre) - vjeçar.

Regjistër, është regjistri i bonove të thesarit dhe regjistri i obligacioneve.

Treg ndërbankar, është tregu në të cilin kryhen rregullisht veprime operacionale ndërmjet bankave.

Data e kontratës është data, në të cilën bankat e përfshira në procesin e tregtimit të letrës me vlerë pranojnë kushtet e tregtimit.

Data e tregtimit është data, në të cilën bankat kryejnë veprimet në llogaritë rrjedhëse pranë Bankës së Shqipërisë.

Data e maturimit të letrës me vlerë, është data në të cilën do të bëhet pagesa e vlerës nominale.

Periudha e mbetur deri në maturim për letrën me vlerë, është numri i ditëve ndërmjet datës së tregtimit dhe datës së maturimit të letrës me vlerë.

PJESA II TREGU SEKONDAR I LETRAVE ME VLERË TË QEVERISË

NENI 3

Në tregun sekondar bankat, shesin dhe blejnë letra me vlerë ndërmjet tyre.

Bankat mund të vendosin letrat me vlerë si garanci për:

- a) veprimet e kreditimit me Bankën e Shqipërisë, siç parashikohet në rregulloret e saj përkatëse të nxjerra për këtë qëllim;
- b) veprimet që ato kryejnë me njëra – tjetrën në tregun ndërbankar.

NENI 4

Letrat me vlerë tregtohen vetëm kur plotësojnë dy kushte:

- a) periudha e mbetur deri në maturim, në ditën e tregtimit, nuk është më pak se shtatë ditë;
- b) nuk janë të vendosura si garanci në Bankën e Shqipërisë.

NENI 5

Bankat në marrëveshje me njëra-tjetrën, kanë të drejtë të përcaktojnë shumën e letrës me vlerë që do të tregtojnë, çmimin dhe periudhën e mbajtjes në zotërim të saj.

NENI 6

Çdo bankë, përpara kryerjes së veprimit të blerjes së një letre me vlerë, ka të drejtë t'i kërkojë informacion Bankës së Shqipërisë, mbi disponibilitetin për shitje të kësaj letre me vlerë. Mënyra e njoftimit apo e konfirmimit nga Banka e Shqipërisë bëhet me një nga format që konsiderohet e vlefshme për vetë bankën, e shprehur prej saj në momentin e kërkesës.

NENI 7

Të dyja bankat e përfshira në veprimin e shitblerjes së letrës me vlerë, në datën e lidhjes së kontratës, duhet të njoftojnë Bankën e Shqipërisë (për ato banka që kanë SWIFT njoftimi duhet të vijë vetëm nëpërmjet tij, ndërsa për bankat që nuk kanë SWIFT, njoftimi duhet të vijë me shkresë zyrtare). Në përmbajtje të këtij njoftimi duhet të shkruhen : data e kryerjes së veprimit, emri i blerësit, emri i shitësit si edhe të dhëna të tjera në lidhje me letrën me vlerë sipas specifikimeve në aneksin 2.

NENI 8

Banka e Shqipërisë bën ndryshimet përkatëse në regjistër, vetëm kur të ketë marrë njoftimet nga të dyja palët. Ajo do të njoftojë bankat për ndryshimet e bëra me një nga mënyrat e përcaktuara në nenin 7.

NENI 9

Banka e Shqipërisë, në bazë të njoftimeve të të dyja palëve, bën ndryshimet përkatëse në regjistër edhe në ato raste kur bankat kryejnë veprime shitblerjeje me njëra – tjetrën, pa kërkuar konfirmim paraprak prej Bankës së Shqipërisë. Kjo e fundit nuk mban përgjegjësi dhe nuk kryen asnjë ndryshim në regjistër, në qoftë se në momentin e njoftimit në Bankën e Shqipërisë letra me vlerë rezulton e regjistruar në regjistrin e garancive. Për këtë, me shkresë zyrtare, ajo do të njoftojë menjëherë, bankat përkatëse.

NENI 10

Rregullimi i fondeve përkatëse në llogaritë e bankave bëhet në bazë të "Rregullave të brendshëm të funksionimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare –AIPS", të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.111, datë 24.12.2003 si edhe "Për disa ndryshime në rregullat e brendshëm të funksionimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare –AIPS", miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 55, datë 29.06.2005.

NENI 11

Bankat, të cilat vendosin letrat me vlerë si garanci, ndjekin, për efekt të kësaj rregulloreje, të njëjtat procedura njoftimi si ato të përcaktuara në pikën 5.4 të rregullores "Mbi kredinë brenda ditës", të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 20, datë 24.03.2004.

NENI 12

Banka e Shqipërisë, për çdo bankë, do të mbajë një regjistër të veçantë për letrat me vlerë të vëna garanci.

NENI 13

Banka e Shqipërisë, brenda 7 (shtatë) ditëve të para të çdo muaji, për llogari të fundit të muajit paraardhës, do të dërgojë pranë çdo banke të regjistruar në regjistrin e letrave me vlerë, njoftimet mbi portofolet e letrave me vlerë të zotëruara prej tyre si edhe ato të vëna si garanci.

NENI 14

Secila nga bankat, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duhet të përgjigjet për përputhshmërinë e të dhënave. Për çdo ndryshim, në qoftë se vërehen të tilla, bankat duhet të raportojnë në Bankën e Shqipërisë, me qëllim kryerjen e sistemeve përkatëse.

NENI 15

Banka e Shqipërisë, përveç detyrimit të përcaktuar në nenet 13 dhe 14, u ofron falas bankave, me kërkesë të tyre, shërbimin e informimit për portofolet e letrave me vlerë.

NENI 16

Banka e Shqipërisë, brenda dy javëve të para të çdo muaji, do të vërë në dispozicion të Komisionit të Letrave me Vlerë të dhënat e rezultuara në fund të muajit paraardhës mbi letrat me vlerë në zotërim të klientëve jobanka.

PJESA III DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

NENI 17

Rregullorja "Mbi tregun me pakicë të bonove të thesarit në Shqipëri", miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.77, datë 7.07.1999 shfuqizohet, me përjashtim të rasteve kur bankat nuk mund të veprojnë sipas kërkesave të rregullores nr. 8/2, datë 28.09.2005 "Mbi tregun me pakicë të bonove të thesarit të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë" të miratuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë. Ky përjashtim është i vlefshëm deri në 31.01.2006.

NENI 18

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës
Ardian Fullani

ANEKS 1

INFORMACION RAPORTUES PËR SHITBLERJE TË LETRAVE ME VLERË

Emri i shitësit _____
Emri i blerësit _____
Nr. ankandit _____
Data e emetimit _____
Data e tregtimit _____
Data e maturimit _____
Periudha deri në maturim _____
Çmimi _____
Shuma e kërkuar _____
Yield-i _____ në përqindje



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

NR.87, DATË 16.11.2005

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.26, DATË 29.03.2000 TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË
BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 26, datë 29.03.2000 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë mbi "Përfashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" në bazë të nenit 1, pika 2 e këtij ligji".
2. Subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë veprimtarinë e kredidhënies dhe që janë përjashtuar nga vendimi i mësipërm, t'u nënshtrohen procedurave për marrjen e licencës në përputhje me rregulloren "Për licencimin e subjekteve jobanka", miratuar me vendimin nr. 96, datë 26.11.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Këto subjekte do të vazhdojnë të raportojnë në Bankën e Shqipërisë.
3. Për këto subjekte në procesin e licencimit si "Kapital fillestar minimal" të shërbejë shuma algjebrike e zërave të mëposhtëm, e vërtetuar nga eksperti kontabël i pavarur:
 - a- të kapitalit të paguar dhe/ose të dhuruar,
 - b- të rezervave të krijuara nga shpërndarja e fitimit,
 - c- të fitimit dhe/ose humbjeve të bartura,
 - d- të fitimit dhe/ose humbjeve ushtrimore.
4. Subjektet e këtij vendimi janë të detyruara të plotësojnë dokumentacionin për licencim jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
5. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij

- vendimi.
6. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit Evropian dhe Komunikimit në Bankën e Shqipërisë për publikimin e këtij vendimi.
 7. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

**SEKRETARI
YLLI MEMISHA**

**KRYETARI
ARDIAN FULLANI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

NR.88, DATË 16.11.2005

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN
"PËR LICENCIMIN E SUBJEKTEVE JOBANKA"**

Në mbështetje të nenit 1, pika 3 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Të miratojë ndryshimet në rregulloren "Për licencimin e subjekteve jobanka", miratuar me vendim nr. 96, datë 26.11.03 të Këshillit Mbikëqyrës si më poshtë vijon :

Pika 1. 4 bëhet pika 1.4.1 dhe shtohet një pikë tjetër, me këtë përmbajtje:

"1.4.2. Përjashtimisht nga pika 1.4.1. subjektet që kryejnë vetëm veprimtarinë e qirasë financiare nuk konsiderohen si subjekte jobanka, sipas përcaktimit të dhënë në këtë rregullore. Veprimtaria e këtyre subjekteve rregullohet në bazë të ligjit nr.9396, datë 12.05.2005 "Për qiranë financiare" dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. "

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit në Bankën e Shqipërisë për publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**SEKRETARI
YLLI MEMISHA**

**KRYETARI
ARDIAN FULLANI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

NR. 89, DATË 16.11.2005

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN
"PËR BLERJET DHE SHËRBIMET NË VLERË TË VOGËL NË BANKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 43, shkronjat (c) dhe (g) të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" me propozimin e Departamentit të Administrimit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Në udhëzimin "Për blerjet dhe shërbimet në vlerë të vogël në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr.16, datë 26.02.2003 dhe ndryshuar me vendimin nr. 40, datë 28.05.2003 të Këshillit Mbikëqyrës, të bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - Në gjithë përmbajtjen e udhëzimit fjalët "shërbime" ose "lloj shërbimesh" të zëvendësohen me fjalën "artikull" dhe emërtimi "Departamenti i Shërbimeve Logjistike" të zëvendësohet me emërtimin "Departamenti i Administrimit".
 - Në pikën 1 të udhëzimit, fjalët "lloj shërbimi" pas fjalës "artikuj" të hiqen.
 - Pika 2 e udhëzimit bëhet:

Në kuptimin e këtij udhëzimi, me artikull duhen kuptuar ata mallra apo shërbime të cilët do të plotësojnë njëkohësisht tre kushte: (i) të kenë të njëjtin emër (ii) të kenë të njëjtat specifikime teknike (iii) të kryejnë të njëjtin funksion.
 - Në pikën 3 të udhëzimit, fjalët "grup mallrash dhe shërbimesh" të zëvendësohen me fjalët "grup artikujsh". Në këtë pikë, në fjalinë e dytë të hiqen fjalët "lloje shërbimesh".
 - Në pikën 5 të udhëzimit, fjalët "llojet e mallrave apo shërbimeve", të zëvendësohen me fjalët "artikujt që do të prokurohen".
 - Në fjalinë e parë të pikës 6 të udhëzimit, fjalët "ose të shërbimeve" të hiqen.
2. Ngarkohen të gjitha strukturat organizative të Bankës së Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**SEKRETARI
YLLI MEMISHA**

**KRYETARI
ARDIAN FULLANI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

NR. 90, DATË 16.11.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
"PËR PROKURIMIN E MALLRAVE, TË SHËRBIMEVE DHE TË NDËRTIMEVE NË BANKËN E
SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 43, shkronjat (c) dhe (g) të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" me propozimin e Departamentit të Administrimit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Në rregulloren "Për prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë" miratuar me vendimin nr.15, datë 26.02.2003 dhe ndryshuar me vendimin nr. 48, datë 18.06.2004 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në kreun VIII "Realizimi i procedurës së prokurimit" neni 4, përkufizimi i fondit limit të ndryshojë në:

"Fond limit" nënkupton vlerën monetare, që përcaktohet nga Kryetari i Entit Prokurues, për realizimin e objektit të prokurimit, referuar buxhetit të Bankës së Shqipërisë dhe studimit të tregut, të realizuar nga Sektori i Prokurimit.
 - b) Në kreun VIII "Realizimi i procedurës së prokurimit" neni 51, shtohen paragrafët me përmbajtjen e mëposhtme:

NENI 51

SEKTORI I PROKURIMEVE

Sektori i Prokurimeve për efekt të kësaj rregulloreje ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore:

Rishikon fondin limit të përcaktuar në buxhet dhe të paraqitur nga departamenti kërkues sipas nenit 45/ç të kësaj rregulloreje, duke u mbështetur në studimin e tregut, në përvojën

e mëparshme të Entit Prokurues si dhe në bazë të çmimeve të publikuara nga INSTAT dhe institucione të tjera shtetërore përkatëse. Rezulati i nxjerrë nga studimi i tregut duhet të bazohet në jo më pak se dy oferta.

Në rastet kur pas procedurës së rishikimit të fondit siç përcaktohet më lart, fondi i nevojshëm për objektin konkret të prokurimit rezulton më i ulët se fondi i paraqitur nga departamenti kërkues, për realizimin e këtij objekti do të përdoret fondi i rishikuar.

2. Në rregullore zëvendësohet në çdo rast emërtimi “Departamenti i Shërbimeve Logjistike” me emërtimin “Departamenti i Administrimit”.
3. Ngarkohen të gjitha strukturat organizative të Bankës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI
YLLI MEMISHA

KRYETARI
ARDIAN FULLANI

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 1, Shkurt 2005

1. Vendim nr.01, datë 26.01.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi zhvillimet ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2004".
2. Vendim nr.02, datë 26.01.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri".
3. Vendim nr.03, datë 26.01.2005 "Për një ndryshim në rregulloren "Për dhënien e licencës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë".
4. Vendim nr.04, datë 26.01.2005 "Për caktimin e afateve të plotësimit të kërkesës për rritjen e kapitalit të kërkuar të bankave".
5. Vendim nr.08, datë 26.01.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun të Bankës së Shqipërisë".
6. Vendim nr.09, datë 26.01.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike në Bankën e Shqipërisë".
7. Vendim nr.10, datë 26.01.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike në Bankën e Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 2, Shkurt 2005

1. Vendim nr.11, datë 09.02.2005 "Për miratimin e dokumentit për misionin e mbikëqyrjes".
2. Vendim nr.12, datë 09.02.2005 "Për dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, të bankës së propozuar "Union Bank" sh.a.".
3. Vendim nr.13, datë 09.02.2005 "Për miratimin e kontratës - tip për marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve të letrave me vlerë".
4. Vendim nr.14, datë 09.02.2005 "Për miratimin e rregullores për dhënien e kredive për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 3, Shkurt 2005

1. Vendim nr.15, datë 23.02.2005 "Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin janar të vitit 2005".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 4, Prill 2005

1. Vendim nr.18, datë 09.03.2005 "Për miratimin e konfigurimeve të vizatimeve të monedhave përkujtimore, që do të shtypen për qëllime numizmatike, në vitin 2005".
2. Vendim nr.19, datë 09.03.2005 "Për mënyrën e vlerësimit të vlerave numizmatike pa kosto në Bankën e Shqipërisë".
3. Vendim nr.22, datë 09.03.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 5, Prill 2005

1. Vendim nr.24, datë 30.03.2005 "Për uljen e përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes nga Banka e Shqipërisë".
2. Vendim nr.27, datë 30.03.2005 "Për shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, për vitin 2006".
3. Vendim nr.28, datë 30.03.2005 "Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 6, Maj 2005

1. Vendim nr. 30, datë 27.04.2005 "Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin mars të vitit 2005".
2. Vendim nr. 31, datë 27.04.2005 "Për një ndryshim në rregulloren për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare".
3. Vendim nr. 32, datë 27.04.2005 "Për miratimin e sistemit raportues për subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare".
4. Vendim nr. 33, datë 27.04.2005 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 25, datë 01.04.2003 për miratimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003".
5. Vendim nr. 35, datë 27.04.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat dhe shpenzimet e daljes jashtë shtetit për shërbim, kualifikim etj., të punonjësve dhe të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 7, Maj 2005

1. Vendim nr. 36, datë 19.05.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat e shtypjes, të rishtypjes dhe të emetimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike nga Banka e Shqipërisë".
2. Vendim nr. 38, datë 19.05.2005 "Për miratimin e rregullores mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore".
3. Vendim nr. 40, datë 19.05.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave të Bankës së Shqipërisë".
4. Vendim nr. 41, datë 19.05.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 8, Qershor 2005

1. Vendim nr. 42, datë 08.06.2005 "Për miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2005".
2. Vendim nr. 43, datë 08.06.2005 "Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim - kreditit dhe unioneve të tyre".
3. Vendim nr. 44, datë 08.06.2005 "Për miratimin e sistemit raportues për shoqëritë e kursim - kreditit dhe të unioneve të tyre".
4. Vendim nr. 45, datë 08.06.2005 "Për disa ndryshime në udhëzimin për kapitalin rregullator të Bankës së Shqipërisë".
5. Vendim nr. 46, datë 08.06.2005 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren për mjaftueshmërinë e kapitalit".
6. Vendim nr. 47, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga fondet për rindërtimin e Kosovës tek Fonds der Republik der Kosova, Gjermani".
7. Vendim nr. 48, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga Fonds der Republik der Kosova, Gjermani tek Francesco Mariano Mariano dhe Banca Popolare Pugliese (Banka Popullore Pulieze)".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 9, Qershor 2005

1. Vendim nr. 49, datë 29.06.2005 "Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin maj të vitit 2005".
2. Vendim nr. 51, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores për procedurat e

- sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)".
3. Vendim nr. 52, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për funksionimin e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH"".
 4. Vendim nr. 53, datë 29.06.2005 "Për "miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH"".
 5. Vendim nr. 54, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat dhe procedurat e sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS"".
 6. Vendim nr. 55, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat e brendshëm të funksionimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 10, Korrik 2005

1. Vendim nr. 56, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Mbi transaksionet e shitbjeve me të drejta të plota"".
2. Vendim nr. 57, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për kredinë lombard"".
3. Vendim nr.58, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për depozitën njëditore"".
4. Vendim nr. 59, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për kredinë njëditore"".
5. Vendim nr. 60, datë 13.07.2005 "Për vendosje komisioni në sportelet e Bankës së Shqipërisë për bonot e thesarit".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 11, Gusht 2005

1. Vendim nr.66, datë 28.07.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi zhvillimet ekonomike dhe monetare për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2005".
2. Vendim nr. 67, datë 28.07.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri".
3. Vendim nr.68, datë 28.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për mbikëqyrjen e konsoliduar".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 12, Shtator 2005

1. Vendim nr.70, datë 31.08.2005 "Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin korrik të vitit 2005".
2. Vendim nr. 71, datë 31.08.2005 "Për miratimin e udhëzimit "Mbi mënyrën e llogaritjes së "fiksit" të kursit të këmbimit të lekut, në Bankën e Shqipërisë"."

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 13, Tetor 2005

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 77, datë 12.10.2005 "Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin gusht të vitit 2005".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 12.10.2005 "Për miratimin e përmbajtjes dhe konfigurimeve të vizatimeve të monedhës që do të shtypet për qëllime numizmatike në vitin 2006".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 14, Nëntor 2005

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 79, datë 31.10.2005 "Për caktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 80, datë 01.11.2005 "Për miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2005".

3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 83, datë 01.11.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit Juridik të Bankës së Shqipërisë".

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558
www.bankofalbania.org
E-mail: public@bankofalbania.org
Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 320 kopje